



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4365 Prot.

Ballsh, më 21.12.2021

VENDIM

Nr. 55 Datë 20.12/2021

**“PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË
MALLAKASTËR, INSTITUCIONEVE NË VARËSI, FUNKSIONEVE TË
TRANSFERUARA DHE TË DELEGUARA PËR VITIN 2022”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, gërma ç), Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore” Ligjit nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr.10405,datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve,VKM nr. 177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civil e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM-s nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, VKM nr.350 ,datë 19.04.2017 “Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,

VENDOSI

- I. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, të institucioneve në varësi,funksioneve të transferuara dhe të delegura për vitin 2022 sipas lidhjes nr.1,2,3,4,5,6,7,8,9, pjesë përbërse e këtij projektvendimi.
- II. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të këshillit bashkiak në masën 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
- III. Miratimin e shpërblimit mujor të kryetarëve të fshatrave në masën 8% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
- IV. Efektet financiare do të fillojnë nga data 01.01.2022.
- V. Ky vendim shoqërohet me relacion justifikues.
- VI. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Mallakaster në zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së tij

KRYETAR

Mbarim Isufaj

